

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-109/12

**Prishtinë
23 maj 2013**

Në çështjen juridike të:

D. J.

Pala përgjegjëse në ankesë/Parashtruesi i kërkesës

kundër

S.I.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarja Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/154/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA31842) të datës 6 qershor 2012 dhe ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/119/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA31845) të datës 7 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 23 maj 2013, lëshoi këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/154/2012, i datës 6 qershor 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA31842, dhe KPCC/D/A/119/2011, i datës 7 shtator 2011, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA31845 dhe hidhen poshtë kërkesat pasi që ato nuk bien në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të KKPK-së.
- 2- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë) brenda afatit 90 (nëntëdhjetë) ditore nga data e dorëzimit të aktgjykimit ose përndryshe përmes ekzekutimit të detyrueshëm.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me datën 12 mars 2007, D. J. kishte paraqitur dy kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte ri-posedim të pronave të ndodhura në Skenderaj, Rudnik, “Starobutici – Kod zadruga”, të cilat përshkruhen si dy ara të ndryshme në ngastrën 1982: njëra me sipërfaqe prej 33 ari e 97 metra katrorë dhe tjetra me sipërfaqe prej 21 ari e 98 metra katrorë. Ai theksonte se babai i tij i ndjerë ka qenë pronar i arave, dhe se ato janë zënë nga një person i panjohur dhe ai kërkon kthimin e posedimit.

Ai ka dorëzuar dy fleta poseduese: njëra e datës 28 shkurt 2001 dhe tjetra nr. 72 e datës 26 shtator 2009, që të dy të lëshuara nga Departamenti i Kadastrit dhe Pronës së Paluajtshme në Skenderaj, që të dy këto në emër të J. C. M.; certifikatën e vdekjes së të ndjerit dhe certifikatën e lindjes së parashtruesit të kërkesës.

KKPK kishte njoftuar palët potencialisht të interesuara duke vendosur shenja njoftuese në pronat me datën 16 qershor 2008. Pas kësaj, më 23 tetor 2010, KKPK kishte lëshuar vendime pozitive në favor të parashtruesit të kërkesës. Më pastaj Komisioni kishte konstatuar se njoftimet kishin qenë të gabuara dhe kishte shfuqizuar vendimet e lëshuara – KPCC/RES/17/2010 të datës 8 mars 2010. Procedura njoftuese ishte përsëritur por këtë herë përmes publikimit në gazetën njoftuese nr.6 të AKP-së me datën 30 korrik 2010 ndaj të cilit njoftim nuk ishte përgjigjur askush.

Me vendimet KPCC/D/A/154/2012, për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA31842 dhe KPCC/D/A/119/2011, për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA31845, KKPK ka konstatuar se kërkesat janë të bazuara. Nuk ka argumente të veçanta për sa i përket kërkesave përkatëse me numrat KPA31842 dhe KPA31845 pasi për to është vendosur në të njëjtën kohë kur është vendosur edhe për disa qindra kërkesa tjera për të cilat është konstatuar se ka prova që bartësi i së drejtës pronësore të ketë qenë pronar i pronave në fjalë.

Vendimi i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës me datën 29 prill 2012.

Më 7 shtator 2012 S. I., tani pala ankuese ka paraqitur ankesa kundër vendimit duke pretenduar në radhë të parë se familja e tij nuk ka qenë e informuar në lidhje me procedurën para AKP-së. Për sa i përket meritave ai sqaron se familja e tij i kishte blerë ngastrat 1981 dhe 1982 në vitin 1973/74 prej D. J. nga Runiki. Ai thekson se me datën 3 shtator 2012 ai e kishte thirrur parashtruesin e kërkesës D. J. i cili i kishte thënë se toka ishte e shitur dhe se nuk ishte ai që kishte bërë kërkesën para AKP-së porse kërkesat ishin paraqitur nga një person me emrin G..

Ankesa i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës i cili në përgjigjen e tij formale ndaj saj thotë se pala ankuese I. I.ka blerë ngastrat nga personi D.J.dhe jo nga ai – D. J. pasi që atë kohë D. ishte personi i autorizuar nga babai i tij M. J.për tu marrë me kësi lloj gjërash. Kërkesa në AKP ishte dorëzuar nga ai (D.) dhe nga i biri i D., J. D. D., i ashtuquajtur G., për të vërtetuar numrin e ngastrave të tyre. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës sqaron në përgjigjen e tij se pasi që nga deklaratat e palës ankuese e kupton se ky i fundit nuk ka dokumente valide për pronat, ai duhet të kontaktoj J. D.-G. i cili është në Mitrovicë dhe avokatin e tij S.I.i nga Skenderaj. Ai sqaron se pala ankuese mund të ripërtërijë bisedat me këta persona në mënyrë që të realizoj bartjen e pronave. Përndryshe, ai thotë (parashtruesi i kërkesës, tani pala përgjegjëse në ankesë) se ai nuk konteston asnjë gjë.

Gjykata Supreme i ka bashkuar lëndët GSK-KPA-A-109/12 dhe GSK-KPA-A-110/12 nën numrin GSK-KPA-A-109/12.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pranueshme edhe pse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën para KKPK-së. Kjo rrethanë nuk mund të shkoj në disfavor të palës ankuese pasi që sigurisht se ai nuk ka qenë i njoftuar në mënyrën e duhur në lidhje me kërkesën. Njoftimi është bërë përmes publikimit të

kërkesës në Gazetën Njoftuese të AKP-së dhe Buletinin e UNHCR-it. Kjo, megjithatë, përbënë “përprjekje të arsyeshme” për të njoftuar në lidhje me kërkesën, siç kërkohet me nenin 10.1 të rregullores, vetëm në raste të jashtëzakonshme. Një rast i tillë nuk mund të gjendet këtu në këtë rast. Pasi që gjykata nuk mund të përjashtoj se pala ankuese nuk ka qenë në dijeni për kërkesën, ai duhet të pranohet si palë në procedurë – ankesat e tij janë të pranueshme.

Megjithatë vendimi i KKKPK-së duhet të anulohet sipas detyrës zyrtare pasi që lëndët nuk bien në kuadër të kompetencave të tij. KKKPK nuk e kishte për detyrë të vendoste në lidhje me meritat e lëndëve por t’i hidhte ato poshtë – neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Pasi që kjo nuk ishte bërë, vendimi i ankimuar duhet të anulohet sipas detyrës zyrtare dhe kërkesat të hedhen poshtë (argumenti sipas nenit 198 (1) të Ligjit për Procedurën Kontestimore i cili është i zbatueshëm *mutatis mutandis* për procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut, UNMIK/REG/2006/50. Sipas nenit 198 (1) të LPK nëse shkalla e parë ka marr një vendim në lidhje me kërkesat të cilat nuk bien në kuadër të kompetencave të saj, gjykata në shkallën e dytë duhet të anuloj vendimin dhe hedhë poshtë kërkesat përkatëse.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Sipas nenit 2, Parimet e Përgjithshme, pika 2.1 e UNMIK/DIR/2007/5 e ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079 “çdo person që ka pasur të drejtën pronësore, posedimin e ligjshëm apo çfarëdo të drejte të ligjshme në pronë të paluajtshme private, i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave drejtpërdrejt të ndërlidhura me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999 apo që kanë rezultuar nga ai, ka të drejtë në rikthimin e së drejtës së tij në pronë, në cilësinë e poseduesit të së drejtës në pronë.

Teksti është i qartë se qëllimi i këtij ligji të veçantë (Rregullores) është të siguroj kthimin e të drejtave pronësore që nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999. Ai nuk shërben për zgjidhjen e kontesteve tjera pronësore të cilat në asnjë mënyrë nuk kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur.

Në rastin aktual është konstatuar se familja e parashtruesit të kërkesës-tani pala përgjegjëse në ankesë, ka humbur posedimin mbi pronat e kërkuara shumë para konfliktit të armatosur, ndonjëherë madje në fillimin e viteve shtatëdhjetë – 1973 apo 1974, kjo domethënë se humbja e posedimit nuk ka qenë aspak e ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998 dhe 1999. Në rast se parashtruesi i kërkesës (pala përgjegjëse në ankesë) konsideron se prona akoma i takon familjes së tij apo atij personalisht, ai do duhej të adresonte këto kërkesa të mundshme te gjykatat e zakonshme. Gjithashtu, ai as nuk e kundërshton faktin se pala ankuese i kishte blerë pronat në vitet e shtatëdhjeta dhe nuk ka tjetër shpjegim për kërkesën e tij para AKP-së përveç dashjes së tij për ta vënë palën ankuese në pozitë për të blerë ato për herë të dytë në mënyrë që të legjitimoj të drejtën e tij pronësore. Pavarësisht nëse ky është një spekulim i pastër apo mundësi e madhe; parashtruesi i kërkesës, tani pala përgjegjëse në ankesë (nëse kështu ai e dëshiron) do të duhet t'i drejtohet gjykatës kompetente lokale me kërkesat e tij pasi që ato nuk kanë të bëjnë me ngjarjet e viteve 1998/1999.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, neni 8.4 i Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të llogaritet në jetë rreth € 5500: € 50, jo më shumë se € 30.

Këto tarifa gjyqësore merren përsipër nga pala përgjegjëse në ankesë i cili ka paraqitur kërkesa të papranueshme. Sipas nenit 46, afati për pagesën e taksave në këtë rast është nga 30 deri në 90 ditë. Gjykata e pranon afatin më të gjatë 90 ditore si të përshtatshëm. Neni 47, paragrafi 3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50%

të shumës së taksës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit e dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it